

Fejton: “Shpërbërja e Jugosllavisë” (17)

A ka qenë e pashmangshme

Mund të nxirren disa faktorë që e kanë shtyrë shpërbërjen: dështimi i ekonomisë, narrativat rivale historike, ambiciet nacionaliste e të tjera. Mirëpo, këta faktorë nuk ishte e thënë që të rezultonin me shpërbërjen e shtetit



Harta e një shteti që më nuk ekziston

Shumë politikanë serbë e kanë shikuar shtetin Jugosllavi si një kornizë brenda së cilës do t'i realizonin idetë e veta ser-bomëdha - pra synonin që të gjitha territoret serbe dhe ato joserbe të qëndronin të bashkuara në një shtet të vetëm. As kroatëve ky parim nuk u prishte punë, ndonëse e dinin se brenda atij shteti, kishte më shumë serbë se kroatë. Natyrisht, kishte edhe në mesin e serbëve dhe të kroatëve, jugosllavë të sin-qertë. Mirëpo, pyetja më e zakonshme e lidhur me shpër-bërjen e Jugosllavisë është klasikja: “A ka qenë e pash-mangshme?” Analizat tregojnë se vetë pyetja tregon mosnjo-huri të gjërave. Mund të nxir-ren disa faktorë që e kanë shtyrë shpërbërjen: dështimi i ekonomisë, narrativat rivale historike, ambiciet nacionaliste e të tjera. Mirëpo, këta faktorë nuk ishte e thënë që të rezul-tonin me shpërbërjen e shtetit.

Këta faktorë ishin vetëm paso-ja të njëri-tjetrit. Po e zëmë, ekonomia e dobësuar nxiste narrativën historike, sipas së cilës, një komb e fajësonte një komb tjetër për hallet e veta. Edhe sistemi komunist shiko-hej nga këndvështrime të ndryshme: serbët e quanin sis-tem antiserb, shqiptarët sistem sllavësh, kroatët antikroatë e kështu me radhë. Kështu siste-mi federativ e demonizonte vetveten. Pala serbe ishte më e frustruara pas vitit 1974, kur Kosova dhe Vojvodina i fituan të drejtat e tyre. Mirëpo, edhe Sllovenia, Kosova e Kroacia nuk ishin të kënaqura me sis-temin. Në këtë situatë u shfaqën liderët nacionalistë si Tugjmani e Milosheviqi. Jack Snyder thotë se Milosheviqi ishte nacionalist vetëm për shkakun se me nacionalizëm mund ta mbante pushtetin. Megjithatë, luftërat dhe jetët e humbura zor se e mbështesin këtë pohim.

“Shpërbërja e Jugosllavisë” është raport i përpiluar nga projekti “Iniciativa e intelektualëve”, rreth të cilit janë mbledhur his-torianë të shumtë nga Ballkani dhe mbarë bota për të hulumtuar gjenezën e konfliktit në ish-Jugosllavi. Ky pro-jekt ka punuar në disa grupe të ndara, të cilat kanë trajtuar aspekte të ndryshme dhe kanë për-piluar raporte të veçan-ta. Grupi që ka punuar raportin rreth “Shpërbërjes së Jugosllavisë” është udhëhequr nga Sabrina Ramet dhe Latinka Peroviq. Për shkak të hapësirës, “Koha Ditore” e boton si fejton një variant të shkurtuar të raportit

A e vlen pushteti gjithë atë gjak të derdhur?

Fund

**Nesër fejtوني i ri:
“”Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)”**

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (3)

Njeriu me vragë

Kapadaiu Frankie Golluscio ia kishte prerë fytyrën me thikë dhe i kishte lënë vraga të këqija. Këto vraga nuk e kanë penguar biondinën irlandeze Mae që të dashurohej pas tij. Al Capone dhe Mae u martuan së shpejti dhe Al bënte punë të ndershme. Derisa, një ditë prej ditësh befas e mori lajmin për vdekjen e të atit

Al Capone po shoqërohej në rininë e tij të hershme me gangsterin Johnny Torrio dhe me shumë rrugaçë të prapë të qosheve të New Yorkut. Mirëpo, nuk jepte sinjale se edhe vetë do të merrej një ditë me punë të pista. Jetonte me prindërit dhe kishte hyrë në punë, pasi e kishin përjashtuar nga puna. Për gjashtë vjet rresht ai kryente punë të ndershme duke punuar në një fabrikë ose si prerës letrash. Ndonjëherë edhe e bënte ndonjë shërbim për Torrion, por punë të tilla bënin të gjithë në mëhallë. “Al Capone ka qenë një kurrkushi. Nuk ka ditur çka është alltia. Çdo natë është kthyer në shtëpi me kohë, kur i ka thënë e ëma. Ka qenë i butë dhe fjalëmbël. Nuk ka qenë i zoti për asgjë, pos për vallëzim”, thotë biografia e tij, Bergreen. Mirëpo, si u shndërrua djali fjalëmbël në carin e nëntokës? Historianët thonë se shndërrimi i tij ka ndodhur pasi është takuar me kalabrezin Frankie Yalen, prej të cilit tmerroheshin të gjithë. Derisa gangsteri Johnny Torrio ishte njeri i qetë dhe punonte me mend, gang-steri Yale ishte gjaknxehtë dhe gjithçka bënte me dhunë. Franki Yale e kishte hapur një kafene në Coney Island dhe djaloshi i ri Al ishte punësuar aty si banakier po ndonjëherë shërbente edhe si kamerier.

Djalë i ri që nuk di frikë, një ditë prej ditësh, Al Capone i ri kishte shkua­r ta shërbente një çift të rinjsh në tavolinë. Mashkulli e kishte pasur kokën të ulur, ndërsa vajza e kishte shikuar kamerierin

çuditshëm.

“Zemër i paske bythët si llokum dhe këtë po ta them për kompliment”, i ishte tekur kamerierit t'i thoshte vajzës. Përcjellësi i vajzës e kishte ngritur kokën. Al Capone nuk e kishte ditur se vajza kishte qenë motra e Frank Galluscios, i cili pa një pa dy e kishte grushtuar kamerierin. Kamerieri ishte bërë gati të rrahej, ndërsa Galluscio e kishte nxjerrë thikën. Ia kishte prerë fytyrën kamerierit në tri vende dhe pas-taj e kishte marrë motrën e tij dhe ishte larguar nga kafeneja. Që atëherë, fytyra e Al Capones kishte mbetur me vraga, por kjo nuk ishte bren-ga e tij e vetme në atë kohë. Frankie Gallusco, një gangster i vocërr, ishte ndier i fyer nga Capone dhe kishte shkua­r të kërkonte hakmarrje nga miku i tij, Lucky Luciano, njëri ndër bosët më të mëdhenj të asaj kohe. Luciano bashkë me Galluscion shkuan te pronari i kafe-nesë Frankie Yale dhe kërkuan ta takonin kamari­er­in problematik. Al Capone i ri doli para tre gangsterëve dhe kërko­i falje që e kishte fyer Galluscion. Frankie Yale ia vuri pastaj dorën në qafë dhe i tha se ndonjëherë njeriu duhet ta përmbajë inatin e tij. Vetë Yale nuk ishte njeri që e përmbante inatin. Ai gjithçka bënte me forcë. Al Capone ishte njeri i fortë dhe mund të shërbente me besnikëri. Kështu, nisën hapat e parë të Al Capones në botën e nëntokës. Ishte nëntëmbëdhjetëvjeçar dhe i dashuruar deri në veshë pas një irlandezeje bionde të quajtur Mae.

Ende ishte kamerier, kur Al Capone u martua me të dashurën e tij Mae. Djali i tyre Albert Francis Capone lindi më 4 dhjetor 1918. Kumbarë i tij ishte Johnny Torrio. Al Capone tani kishte grua dhe fëmijë dhe nuk e kishte ndërmend të merrej me punë të pista, ndonëse i kishte kryer disa punë për nëntokën. Së shpejti e la punën te Frankie Yale dhe nisi të punonte në një firmë ndërtimore. Mirëpo, atëherë më 14 nëntor 1920, babai i Al Capones, vdiq papritmas nga një sulm në zemër. Historianët thonë se që nga ajo ditë Al Capone ishte transformuar. Kumbara Johnny Torrio ia kishte bërë një ofertë që ta ndihmonte në disa punë në Chicago. Me përvojë në punët e nder-shme dhe me përvojë në punët e dhun-shme të Frankie Yalet, Capone tashmë ishte një material i mirë për botën e krimit.

(Në numrin e nesërm: Pse Chicagoja ishte vend i përkryer për krim-inelët? Kush ishte cari i Chicagos në vitin 1920? Kush e vrau carin e Chicagos?)



Al Capone

Gangsterë të tjerë të shquar

Carlos Marcello

Carlos Marcello ka lindur më 1910 në Tunizi, në Afrikë, dhe shumë herët ka emigruar në Amerikë, ku si i ri i ka shijuar grilat e burgut, pasi ishte zënë në vepër duke plaçkitur një bankë. Shumë i ri ishte shoqëruar me Frank Costellon, shefin e mafisë në New York dhe në vitet dyzet ka marrë nën kontroll biznesin e bixhozit në Louisiana. Më 1959, Marcello është marrë në pyetje nga komiteti i senatit amerikan për hetim të krimit të organizuar. Udhëheqës i këtij komiteti ka qenë senatori Robert Kennedy, ndërsa vëllai i tij, senatori John Kennedy ka qenë anëtar i komitetit. Disa vjet më vonë, John Kennedy u bë president i SHBA-së dhe e emëroi vëllanë Bobbyn prokuror të përgjithshëm të shtetit. Vëllezërit Kennedy bënëin përpjekje për ta dëbuar nga SHBA-ja Marcellon. Marcello është kthyer tinëz në SHBA dhe është betuar se do t'i vriste të dy Kennedyt. Nuk ka shkua­r shumë kohë e është vrarë presidenti John Kennedy. Mafiozi Jack Ruby kishte biseduar me Marcellon dhe me mafiozin tjetër Santos Trafficante. FBI-ja e ka marrë në pyetje Marcellon, por nuk e ka konsideruar të dyshimtë për vrasjen e Kennedyt. Mirëpo, në një shkrim më 1992 të gazetës “New York Post” janë dhënë shumë dëshmi se Marcello e Traffikante kanë pasur gisht në vrasjen e Kennedyt. Carlos Marcello ka vdekur më 1993, në moshën 83-vjeçare.